



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E BRENDSHME

SIGURIA DHE PUNËT E BRENDSHME

» Gusht 2024



ME MINISTRIN E BRENDSHËM TË BAVARISË PËR THELLIMIN E BASHKËPUNIMIT NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR

Ministri i Brendshëm Ervin Hoxha priti në një takim zyrtar, Ministrin e Brendshëm të Landit të Bavarisë, Joachim Herrmann. Ministrat konfirmuan se Shqipëria dhe Gjermania kanë marrëdhënie të shkëlqyera, mbështetur në një dialog intensiv politik të nivelit të lartë dhe pohuan se bashkëpunimi mes dy policive është shumë funksional. Gjithashtu, mbështetën idenë e hedhur nga stafet teknike për patrullime të përbashkëta, eksperiencë që funksionojnë mes disa shteteve.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

01

MINISTRI I BRENDSHËM NË INSPEKTIMET NË VIJËN BREGDETARE PËR MBARËVAJTJEN E SEZONIT TURISTIK



Ministri i Brendshëm Ervin Hoxha, së bashku me drejtues e forca të Policisë Kufitare të Vlorës dhe të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit inspektuan vijën bregdetare nga Himara deri në Sarandë, për të parë nga afër zbatimin e masave për rritjen e parametrave të sigurisë detare. Ministri i Brendshëm kërkoi nga autoritetet t'i kushtojnë vëmendje të veçantë kushteve të lundrimit, kapaciteteve të lundrimit si dhe vendeve të ankorimit dhe imbarkimit të pushuesve, për të shmangur çdo incident me pasoja.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

02

ME DREJTUESIN E ICITAP PËR TRAJNIMET PROFESIONALE TË DREJTUESVE POLICORË DHE FUQIZIMIN TEKNOLOGJIK



Ministri i Brendshëm Ervin Hoxha priti në një takim drejtuesin e ICITAP Richard Deasy, me të cilin bisedoi për çështjet e thellimit të bashkëpunimit në lidhje me zhvillimin e kapaciteteve të agjencive ligjzbatuese, veçanërisht për Policinë e Shtetit. Ministri Hoxha falënderoi ICITAP dhe qeverinë amerikane për mbështetjen e dhënë dhe konfirmoi gatishmërinë maksimale për thellimin e këtij bashkëpunimi.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

03



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E BRENDSHME

SIGURIA DHE PUNËT E BRENDSHME

» Gusht 2024

ME KREUN E INTELIGJENCËS SË PËRGJITHSHME TË ARABISË SAUDITE: DAKORDËSI PËR SHKËMBIM EKSPERIENCASH E INFORMACIONI



Ministri i Brendshëm Ervin Hoxha priti në takim Shkëlqesinë e Tij, Khalid bin Ali bin Abdullah Al Humaidan, President i Inteligjencës së Përgjithshme, në Mbretërinë e Arabisë Saudite. Ministri Hoxha shprehu falënderimet për bashkëpunimin, të cilin e vlerësoi si të shkëlqyer, të ndërtuar mes dy vendeve. Palët dakordësuan për zhvillimin më tej të kapaciteteve dhe mundësive në shkëmbimin e eksperiencave, shkëmbimin e informacionit, si dhe vendosjen e pikave të kontaktit mes dy palëve.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

04

ME TË NGARKUARËN ME PUNË TË SHBA NË TIRANË: MUNDËSI TË REJA PËR ZGJERIM TË BASHKËPUNIMIT



Ministri i Brendshëm Ervin Hoxha priti në një takim të Ngarkuarën me Punë të SHBA-ve në Tiranë, Nancy VanHorn, me të cilën bisedoi rreth marrëdhënieve dypalëshe, duke vënë në dukje miqësinë e fortë mes dy vendeve, bashkëpunimin dhe partneritetin e fortë strategjik. Ministri Hoxha falënderoi përfaqësuesen e Ambasadës së SHBA për mbështetjen e pakursyer ndaj agjencive ligjzbatuese të Shqipërisë, veçanërisht programin ICITAP, me fokus asistencën për Policinë e Shtetit.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

05

ME AMBASADOREN E KANADASË PËR MBËSHTETJE NË LUFTËN KUNDËR KRIMIT TË ORGANIZUAR, PASTRIMIN E PARAVE DHE TRAJNIMET POLICORE



Ministri i Brendshëm Ervin Hoxha priti në një takim Ambasadoren e Kanadasë, Elissa Goldberg me të cilën bisedoi rreth bashkëpunimit dypalësh, me fokus në çështjet e sigurisë dhe luftës kundër krimit të organizuar. Ministri Hoxha kërkoi intensifikim në çështje të bashkëpunimit policor, sidomos sa i përket shkëmbimit të informacioni midis strukturave për luftën kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit. Ambasadorja shprehu gatishmërinë për mbështetje të Kanadasë ndaj Shqipërisë për çështjet me interes të përbashkët si lufta kundër krimit të organizuar, pastrimi i parave, problemet e migracionit, si dhe për trajnimet profesionale dhe efektive të Policisë së Shtetit.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

06



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E BRENDSHME

SIGURIA DHE PUNËT E BRENDSHME

» Gusht 2024

MIRATOHET PAGESA PËR ORËT SHITESË TË PUNONJËSVE TË POLICISË GJATË SEZONIT TURISTIK DHE KOMPENSIMIN FINANCIAR USHQIMOR

Punonjësit e Policisë së Shtetit do të përfitojnë pagesat për orët shtesë në sezon dhe kompensimin ushqimor, për vitin 2024. Në Aktin e miratuar, parashikohet të mbulohet efekti financiar i orëve shtesë të punonjësve të policisë të angazhuar në shërbim gjatë sezonit turistik. Po ashtu, me këto shtesa në Aktin Normativ, do të mbulohet edhe efekti financiar i kompensimit në lekë për ushqimin, për punonjësit e policisë për gjithë vitin buxhetor 2024.

AKTI NORMATIV
+1.3 MILIARD LEKË

**PUNONJËSIT E POLICISË
SË SHTETIT PËRFITOJNË**

KOMPENSIMIN USHQIMOR &
PAGESËN PËR ORËT SHITESË,
PËRGJATË SEZONIT TURISTIK



mb.gov.al

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

07

NGRIHET STACIONI I RI ZJARRFIKËS NË FIER, MINISTRI HOXHA: LIGJ TË RI DHE RIORGANIZIM TË SHËRBIMIT ZJARRFIKËS

Ministri i Brendshëm Ervin Hoxha mori pjesë në ceremoninë e përrurimit të stacionit të ri zjarrfikës të bashkisë Fier.

Stacioni i ri zjarrfikës i Fierit është një strukturë moderne që u realizua në kuadër të projektit “Forcimi i Kapaciteteve të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit të Shqipërisë”, i cili zbatohet nga UNDP Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Brendshme dhe pushtetin lokal.

Ministri theksoj se “Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi ka sot më shumë se kurrë nevojë për një ristrukturim, për t’iu përgjigjur më shpejt dhe më me cilësi nevojave të qytetarëve. Për këtë arsye, Ministria e Brendshme po rishikon ligjin e këtij shërbimi, duke pasur si synim riorganizimin e shërbimit zjarrfikës, qoftë në bashki, apo bashki qendër qarku, apo në një formë tjetër.

BULETINI MUJOR I MB

WWW.MB.GOV.AL

08

